

FJALA E DEPUTETIT EDUARD NDRECA

E ENJTE 4 NËNTOR 2021

Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Në fakt, nuk do të zgjatem shumë.

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Unë edhe në cilësinë e deputetit të Partisë Socialiste, por edhe në planin personal, mendoj se ky ligj është një instrument i jashtëzakonshëm në duart e qytetarëve. Besoj se që nga nismëtarët, me punën që ka bërë relatorja dhe komisionet nëpër të cilat ka kaluar, ky projektligj ka ardhur aq i denjë në këtë sallë, sa për t'u votuar, si nga kolegët e maxhorancës, ashtu edhe nga kolegët e opozitës. E thashë që nuk do të ndalem shumë, sepse shumëçka doli në këtë foltore, por mendoj se përveç faktit se qytetarët do ta kenë një instrument të rëndësishëm në duart e tyre, ky ligj duhej të ishte votuar, e ndoshta është votuar, edhe nga opozita, kjo ngaqë besoj e jam shumë i bindur, dhe koha do ta tregojë, që ky ligj do të jetë një instrument shumë i rëndësishëm edhe në duart e opozitës. Do t'i them pak më poshtë dy arsytet se përse ky ligj do t'i vlejë shumë edhe opozitës, po përpara se të kaloj atje, kur ne e miratuar në komisione, qoftë në parim, qoftë nen për nen, në fakt patëm edhe ankesa. Patëm ankesa të natyrës: ç' është Kuvendi ynë, ç' është nisma jonë, ç' është fjala ime, ç' është takimi apo nisma e prindërve, e mësuesve dhe e nxënësve së bashku e të tjera e të tjera. Tani, të thuash ç' është Kuvendi, kjo më duket pak si jo normale. Kuvendi është themeli i demokracisë. Sa më shumë kuvende të ketë, aq më funksionale është demokracia. Ka lindur që në kohën e Solonit, Babait të Demokracisë. Ç' është fjala ime, thonë ca kolegë. Pak më tutje, kur kalonte puna në komision, ankoreshin ata që mendonin që po u prekej fjala e lirë, te kryetarja e komisionit, sepse fjala është e para. E ka thënë edhe Bibla. Po, po, fjala është e para. Prandaj aty është fjala dhe do të jetë fjala e qytetarëve, sepse kësisoj qeveria, por edhe të gjithë ne, në fakt, do të jemi në rregull edhe me qytetarët, edhe me Biblën. U ankuan po ashtu për të dhënat. Pra, ideja ishte se një qytetar që do të ankohej atje, duhej të jepte të dhënat e veta. Po, patjetër, me të dhëna, sepse po kërkon zgjidhjen e një problemi të caktuar. Nuk është qytetari dixhital, që duhet të padisësh pa emër, e pastaj të të marrë goja e ligë e kujtdo, të cilit i del përpara ajo pasqyra e qytetarit digjital. E thashë edhe në fillim: unë mendoj se opozita kishte dy arsye të forta për ta votuar, nëse e ka votuar, ka bërë mirë, sepse, në qoftë se do të ketë një institucion që do të jetë në hall të madh me këtë ligj që do të miratohet, do të jetë qeveria shqiptare, pa dyshim, do të jenë institucionet e këtij vendi. Do të jenë në hall të madh, patjetër. Do të ketë lumë ankesash, sepse jo gjithçka është bërë mirë në institucione. Do të ketë lumë kërkesash, fjalësh, nismash, në shërbim të përmirësimit të jetës së qytetarëve. Patjetër, jo gjithçka do të bëhet në mënyrë të përsosur. Unë jam i bindur, sepse e përsosura ka standard.

Këtu mund të gjenit argument për të zënë edhe pak minuta më tepër në foltore në lidhje me gjithçka që ndoshta s' bëhej si duhej atje. Së dyti, opozita duhej ta votonte këtë projektligj, sepse në fushatën e vet elektorale ka bërë premtime të panumërta, patjetër për gjëra që i ka parë se s' janë siç duhet,

për gjëra që kanë munguar në të gjitha zonat e tyre. Patjetër që ka probleme, sepse unë s'e kam parë asnjëherë as Kryeministrin tim, as këtë qeveri, që të heq ndonjë paralele me Gjermaninë. Atëherë, ju duhej ta shfrytëzonit këtë ligj për të realizuar premtimet që keni dhënë në fushatë, të organizonit nisma, të denonconit abuzime të zyrtarëve të ndryshëm me detyrën, patjetër të mbliidhni edhe kuvende për të kërkuar më të mirën në të gjitha zonat ku keni përfaqësues. E kështu, jam shumë i bindur se qeveria do të reagonte, këto probleme do të zgjidheshin, ju do të dilnit ballëhapur përpara votuesve tuaj dhe do të kishit moral të lartë për të shkuar sërish pas katër viteve të kërkonit votën, sepse i keni realizuar premtimet. (Ndërprerje e shkurtër incizimi) Sepse diskutimet e kanë bërë efektin e vet dhe gjërat janë trajtuar. Kësisoj, uroj që ky ligj të ketë marrë votën e të gjithëve këtu, në këtë sallë, por në mos jo, jam i bindur se në të ardhmen edhe ju do ta vlerësoni maksimalisht. Faleminderit shumë!